



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government



Zyra e Kryeministrit / Ured Premijera / Office of the Prime Minister

Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore
Kosovska Agencija za Zastitu od Zracenje i Nuklearnu Sigurnost
Kosovo Agency for Radiation Protection and Nuclear Safety

RAPORT VJETOR I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2020

Shkurt 2020

Edhe pse në kohë pandemie, inspektorati i AKMRrSB-ës ka punuar si çdo vit në zbatim të detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve që jep ligji për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore me numër 06/L-029.

Mision kryesor ka qenë mbrojtja e punonjësve profesional, pacientëve, përcjellësve, publikut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të rrezatimeve, duke krijuar një sistem të administrimit dhe kontrollit të mbrojtjes nga rrezatimet, në përputhje me ligjin me nr: 06/L-029 për “Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe për Sigurinë Bërthamor” dhe standardet ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor i inspektimeve ka qenë monitorimi, vlerësimi dhe zbatimi i legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, afatet dhe kushtet e licencave, autorizimeve, lejeve për persona fizik dhe juridik që përdorin burime të rrezatimit jonizues, jo-jonizues apo kanë në posedim burime apo mbetje radioaktive.

Me gjithë problemet e hasura gjatë vitit 2020 (periudha e pandemisë, ku isha i infektuar me COVID-19, burimet njerëzore, etj.) plani i inspektimeve është realizuar në masë 86% nga ai i planifikuar.

Në bazë të planit vjetor të inspektimeve për vitin 2020 janë kryer inspektime:

- Të përbashkëta me FSK-në/KFOR-in, MEA dhe AME,
- Për rrufepritësit radioaktiv,
- Për mbetjet radioaktive,
- Kabinetet e radiologjisë publike dhe private që kanë në përdorim pajisje që prodhojnë rreze X si dhe në ato qendra ku aplikohen burimet e hapura dhe të mbyllura radioaktive,
- Monitorimet e ndotjes radiologjike të ujit dhe tokës të shkaktuara nga aktivitetet industriale, mjekësore, kërkimore/shkencore si dhe raste të incidenteve dhe aksidenteve radiologjike dhe bërthamore.

Gjatë hartimit të planit për inspektime për vitin 2020, prioriteti i është dhënë inspektimit të rrufepritësve dhe mbetjeve si burime radioaktive si dhe nga sektori i shëndetësisë, me fokus spitalet regjionale në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Nga inspektimet e kryera në këto kabinete radiologjike në disa raste janë konstatuar edhe parregullsi. Një nga elementet që ndeshet më së shpeshti është se stafi teknik në shumë raste nuk është profesional (teknik me profile të ndryshme, pra nuk janë teknik apo Bachelor të radiologjisë), nuk kanë trajnime për mbrojtje nga rrezatimi, pajisje mbrojtëse jo të mjaftueshme, etj.

Një problematikë tjetër është se shërbimi radiologjik në shumë raste disponon aparatura të vjetra dhe se me këtë nuk kanë realizuar ndonjë kontroll teknike të pajisjes/pajisjeve (kualiteti i kontrollit të rrezatimit).

Inspektimet kanë përfshirë (industri apo në shëndetësi) qytetet: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, etj. Inspektimet e përbashkëta me KFOR-in/FSK-në janë kryer në bazë të planit të përgjithshëm vjetor për inspektime nr. 06/2020, si dhe planit të KFOR/KSF TIM INSPECTION PLAN 2020.


Me qëllim të një vlerësimi sa më korrekt dhe profesional gjatë inspektimit, është hartuar edhe një procesverbal ku nëpërmjet tij janë dhënë rekomandimet apo vërejtjet e nevojshme. Pas realizimit të inspektimit është përgatitur një raport i detajuar lidhur me konstatimet e gjendjes në aspektin e sigurisë dhe sigurimit radiologjik. Të gjitha të dhënat janë futur në bazën e të dhënave qendrore të AKMRrSB-ës. Numri i përgjithshëm i inspektimeve të realizuara për gjatë vitit 2020 është 43 nga 50 të planifikuara.

Nga sektori i shëndetësisë mund të i përmbledhim këto elemente kryesore që kanë të bëjnë me përdorim të sigurt të burimeve radioaktive dhe pajisjeve që prodhojnë rrezatim, e nga këto kemi:

- Klasifikimi i zonave (zona A apo zona B)
- Hapësirat, pajisjet dhe kushtet për mbrojtjen nga rrezatimi,
- Kontrolli teknik i pajisjeve,
- Kontrolli i kualitetit të radio farmaceutikëve,
- Monitorimi individual dozimetrik (TLD),
- Monitorimin i kushteve në vendin e punës,
- Monitorimi sistematik shëndetësor,
- Trajnimet,
- Menaxhimi i mbetjeve radioaktive,
- Plani i emergjencës,
- Fizikan mjekësor,
- Zyrtar për Mbrojtje nga Rrezatimi.

Më poshtë në bazë të grafikëve dhe tabelave kemi paraqitur llojin e inspektimeve (private dhe publike), kategorizimin e inspektimeve (burime radioaktive në industri, rrufepritës, mbetje radioaktive, shëndetësi, KFOR/FSK, etj.).

Në grafikun nr.1 është paraqitur numri i inspektimeve të realizuara në institucionet publike dhe ato private gjatë vitit 2020.




Grafiku 1: Numri i inspektimeve nga institucionet publike dhe private - 2020

Grafiku 1 paraqet numrin e inspektimeve në institucionet publike (shtetërore) dhe private, andaj me këtë shihet se 27 inspektime janë realizuar në institucionet publike dhe 16 në ato private, që në total gjithsej janë realizuar 43 inspektime gjatë vitit 2020. Nga numri i inspektimeve të realizuara shihet se plani i inspektimeve është realizuar mbi 86%.

Numri më i madh i inspektimeve është nga sektori publik. Duke marrë parasysh numrin e punonjësve që bartin dozimetra personal (TLD), atëherë rezulton se sektori publik ka përafërsisht mbi 450 punonjës, apo në përqindje 80%, nga ai privat që ka mbi 130 apo 20% (këto shifra mund të lëvizin nga regjistrimet e praktikave të reja). Kjo është arsyeja pse janë bërë më shumë inspektime në sektorin publik.

Sipas natyrës së punës, numri i përgjithshëm i punonjësve profesional të ekspozuar si punonjës shëndetësorë është në masë 93%, ndërsa pjesa tjetër në përqindje 7% është e punonjësve profesional që janë të angazhuar në të gjitha praktikat tjera jo-mjekësore.

Grafiku 2 parqet kategorizimin e inspektimeve gjatë vitit 2020, pra llojin dhe numrin e inspektimit. Nga ky grafik shihet se numri më i madh i inspektimeve të realizuar gjatë vitit 2020 është ai për grumbullimin e mostrave të ujit dhe të dheut, pastaj për rrufepritisit radioaktiv, sektori i shëndetësisë, etj. dhe më i vogël për burime të hapura radioaktive.



Grafiku 2:Kategorizimi dhe numri i inspektimeve - 2020

Nga grafiku 2 shihet se numri më i madhe i inspektimeve është realizuar gjatë grumbullimit të mostrave të ujit dhe dheut, gjithsej 19 mostra. Qëllimi i marrjes së mostrave ka qenë monitorimi i ndotjes radiologjike të ujit dhe dheut të shkaktuara nga aktivitetet e mundshme industriale, mjekësore, kërkimore/shkencore, etj.

Mostrat janë marrë sipas planit për grumbullimin e mostrave për vitin 2020. Janë marrë, etiketuar, pakeluar dhe dërguar për analiza në Belgjikë në Institutin për Radio Elemente (IRE). Duhet cekur se monitorimi radiologjik i ujit (puse, burime, liqene dhe lumenj) dhe tokës në vendin tonë bëhet që nga viti 2013 e këndej, duke iu falënderuar qeverisë belge përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Sipas numrit rendor të realizimit të inspektimeve, pas atyre për grumbullim të mostrave të ujit dhe dheut, janë rrufepritisit radioaktiv me gjithsej 8 inspektime. Kjo është bërë me arsyetim se niveli i sigorisë për këto burime është i ultë. Është shumë me rëndësi të ceket se gjatë vitit 2020 janë gjetur dy (2) rufepritis që deri më tani nuk ishin në bazën e të dhënave të AKMRrSB-ës. Tani këto rufepritis radioaktiv ruhen nga ato ndërmarrje nga ku janë gjetur.

Andaj duke marrë parasysh se shumica e këtyre vendeve ku gjinden këto rufepritis radioaktiv janë në pronësi të AKP-së (Agjencia Kosovare të Privatizimit) dhe se në shumë raste në këto subjekte nuk ka as roje fizike dhe se për këtë qëllim rufepritisit radioaktiv hyjnë si kategori me prioritet në planin vjetor për inspektime. Gjendja fizike e rufepritisve të inspektuar fatmirësisht ishte e kënaqshme.

Nga sektori i shëndetësisë janë realizuar gjithsej 6 inspektime, 5 nga praktikat me përdorim të pajisjeve që prodhojnë rrezatim jonizues dhe 1 nga ato që përdorin burime radioaktive të hapura (Mjekësia Nukleare).

Po ashtu sipas grafikut 2 shihet se janë realizuar 4 inspektime për mbetjet radioaktive, nga të cilat gjatë inspektimit është konstatuar se gjendja e tyre ishte e mirë.

Bazuar në planin për inspektime “KFOR/KSF TIM INSPECTION PLAN 2020”, me KFOR-in, FSK-në, AME, MEA, etj., janë realizuar 3 inspektime.

Po ashtu në bazë të grafikut 2 është shumë me rëndësi të ceket se gjatë vitit 2020 janë gjetur dy (2) burime radioaktive. Përmes procedurave administrative dhe teknike është bërë trajtimi dhe paketimi i tyre dhe se këto dy mbetje ruhen në ndërmarrjet nga ku janë gjetur dhe i janë shtuar listës së bazës qendrore të AKMRrSB-ës për mbetje radioaktive.

Me respekt,
Fadil HASANI, Inspektor.